



## **Federata e Futbollit e Kosovës**

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

## **PËRMBAJTJA**

## **FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

5



## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Menaxhmentit të Federatës së Futbollit të Kosovës

#### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Federatës së Futbollit të Kosovës, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Federatës së Futbollit të Kosovës më 31 Dhjetor 2021, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale në fuqi.

#### **Baza për Opinion**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

#### **Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel I lartë I sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim I kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë.

Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

*Astrit Musa*

Astrit Musa – Auditor Llogar

ACA – Audit & Consulting Associates

Prishtinë, Kosovë

9 Mars, 2022



**Federata e Futbollit e Kosovës**  
**Pasqyra e Pozitës Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

		Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
<b>ASETET</b>			
<b>Asetet qarkulluese</b>			
Paraja dhe ekuivalentet e parësë	3	2,256,406	3,286,510
Llogaritë e arkëtueshme	4	562,797	220,272
Avanset e dhëna	5	50,121	260,015
Stoku		<u>420,520</u>	<u>381,130</u>
<b>Totali i aseteve qarkulluese</b>		<b><u>3,289,843</u></b>	<b><u>4,147,929</u></b>
<b>Asetet jo qarkulluese</b>			
Automjete & Kompjuterat	6	<u>1,183,570</u>	<u>408,461</u>
<b>Gjithsej astete jo qarkulluese</b>		<b><u>1,183,570</u></b>	<b><u>408,461</u></b>
<b>TOTALI I ASETEVE</b>		<b><u>4,473,413</u></b>	<b><u>4,556,389</u></b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>Gjendja e fondeve</b>			
Fondi 01.01.2021		3,335,034	3,389,813
Teprica/(Mungesa) për vitin		<u>(23,345)</u>	<u>(54,780)</u>
<b>Gjithsej gjendja e fondeve</b>		<b><u>3,311,689</u></b>	<b><u>3,335,034</u></b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme	7	<u>228,761</u>	<u>129,552</u>
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b><u>228,761</u></b>	<b><u>129,552</u></b>
<b>Detrimet afatgjata</b>			
Detyrimet nga të hyrat e shtyra	8	<u>932,963</u>	<u>1,091,804</u>
<b>Gjithsej detyrimet afatgjatë</b>		<b><u>932,963</u></b>	<b><u>1,091,804</u></b>
<b>TOTALI I FONDEVE DHE DETYRIMEVE</b>		<b><u>4,473,413</u></b>	<b><u>4,556,389</u></b>

Pasqyrat financiare janë nënshkruar në 9 Mars 2022 nga:

Agim Ademi

Presidenti i FFK-së

Sami Jerliu

Kontabilist i Çertifikuar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 15 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Federata e Futbollit e Kosovës**  
**Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

		<b>31 Dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2020 (në EUR)</b>
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat	<b>9</b>	<b>13,916,472</b>	<b>11,958,589</b>
<b>Totali i të hyrave</b>		<b>13,916,472</b>	<b>11,958,589</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet e zhvlerësimit	<b>6</b>	292,898	107,816
Shpenzimet e pagave	<b>10</b>	4,305,416	3,292,618
Shpenzimet programore	<b>11</b>	5,508,279	4,575,724
Shpenzimet e UEFA-së	<b>12</b>	2,439,112	2,761,900
Shpenzimet e investimeve dhe mirëmbajtjes	<b>13</b>	1,251,672	1,115,186
Shpenzimet e administratës	<b>14</b>	142,440	160,124
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>13,939,817</b>	<b>12,013,369</b>
<b>Pjesa e mbetur</b>		<b>(23,345)</b>	<b>(54,780)</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 15 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

---

	Teprica/Mungesa e akumuluar	Gjithsej
<b>Pasqyra e Tepricave/Mungesave</b>		
<b>Më 1 janar 2020</b>	3,389,813	3,389,813
Teprica (mungesa) për vitin	(54,780)	(54,780)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<u><b>3,335,034</b></u>	<u><b>3,335,034</b></u>
<b>Më 1 janar 2021</b>	3,335,034	3,335,034
Teprica (mungesa) për vitin	(23,345)	(23,345)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<u><b>3,311,689</b></u>	<u><b>3,311,689</b></u>

Mbetja në vlerë 23,345 euro për vitin 2021 nuk është përfshirë te të hyrat e shtyera sepse kjo vlerë është shpenzuar nga fondet ashtu siq është pasqyruar tek gjendja e fondeve në Pasqyrën e Pozitës Financiare.

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 15 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

---

**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese</b>		
Teprica(Mungesa) neto për vitin	(23,345)	(54,780)
Rregullimet për:		
Zhvlerësimin	292,898	107,816
Shpenzimet financiare	-	-
	<u><b>269,553</b></u>	<u><b>53,036</b></u>
<i>Lëvizjet në kapitalin punues:</i>		
Të arkëtueshmet	(342,524)	31,604
Stoku	(39,390)	(40,807)
Parapagimet	209,895	3,108
Detyrimet	99,209	50,501
<b>Rrjedha e parasë neto nga aktivitetet operative</b>	<u><b>196,743</b></u>	<u><b>97,442</b></u>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>	-	-
Blerja e paisjeve	(1,068,008)	(12,901)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<u><b>(1,068,008)</b></u>	<u><b>(12,901)</b></u>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Pranimi/Pagesa-Teprica/Mungesa e mjeteve	(158,841)	(2,787,628)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<u><b>(158,841)</b></u>	<u><b>(2,787,628)</b></u>
<b>Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent</b>	<b>(1,030,105)</b>	<b>(2,703,088)</b>
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	3,286,510	5,989,598
<b>Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor</b>	<u><u><b>2,256,406</b></u></u>	<u><u><b>3,286,510</b></u></u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 15 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare



**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

---

**1. HYRJE**

***Historiku dhe plotikat operative***

Federata e Futbollit e Kosovës është një organizatë joqeveritare, jopolitke, e pavarur, joprofitabile dhe vullnetare sportive, ka statusin e personit juridik, është organizata e vetme kompetente që organizon, udhëheqë dhe rregullon garat e futbollit në territorin e Republikës së Kosovës, është e themeluar në principet e frymës sportive dhe të fair play-it.

FFK është themeluar me 20.01.2000 me seli në Prishtinë, është regjistruar si OJQ po me të njejtin emër sipas Rregullorës së UNMIK-ut 1999/22 me Numër të Regjistrimit 5100477-9, reregjestrimit e ka bërë me 29.05.2009 sipas Ligjit Nr.03/L-134, "Për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës".

Me numër fiskal FFK-ja është paisur me 31.10.2009. Numri fiskal i lëshuar nga ana e ATK-së është 600062327.

***Qëllimet (Objektiva)***

Qëllimet (Objektivat) e FFK-së janë këto:

- Të zhvillojë, promovojë dhe rregullojë në mënyrë konstante lojën e futbollit në të gjitha format e tij në territorin e Republikës së Kosovës, në dritën e fair play-it, vlerave kulturore, educative dhe humanitare sidomos nëpërmjet të masovizimit dhe zhvillimit të programit për të rinjë.
- Të organizojë garat e FFK-së në nivel nacional në të gjitha kategoritë.
- Të organizojë dhe të drejtojë garat e futbollit duke I zhvilluar dhe afirmuar,
- Të respektojë dhe mbrojë Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-së dhe UEFA-së, si dhe rregulloret e lojës, duke u kujdesur që ato të respektohen nga anëtarët e saj.
- Të mbikqyrë dhe kontrollojë të gjitha ndeshjet zyrtare dhe miqësore në të gjitha format e saja, që luhen në territorin e Kosovës.
- Të drejtojë marrëdhëniet ndërkombëtare sportive dhe ato nacionale të lidhura me Federatën e Futbollit të Kosovës në të gjitha format e saja.
- Të parandalojë të gjitha metodat dhe aktivitetet, të cilat do të mund të rrezikojnë integritetin e ndeshjeve dhe garave ose që don të keqpërdornin lojën e futbollit.

## **2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL**

### **2.1 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të kontabilitetit akrual për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

### **2.2 Valuta e përdorur**

Valuta funksionale e Organizatës është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

### **2.3 Stoqet**

Stoqet janë dhënë në koston më të ulët dhe vlerën e realizueshme neto.

### **2.4 Prona, impiantet dhe pajisjet**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Prona, toka dhe pajisjet e biznesit janë deklaruar në pasqyrën e pozicionit financiar me koston historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e dëmtimit në vlerë.

Paisjet paraqiten me koston e tyre minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia e vlerës së tyre. Zhvlerësimi njihet në mënyrë që të anulohet koston apo vlerësimin e mjeteve minus vlerat e mbetura mbi dobishmërinë e tyre, duke përdorur metodën lineare. Jetëgjatësia, vlera e mbetur dhe metoda e amortizimit rishikohen në çdo datë raportimi, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësim, atëherë ndryshimet llogariten në periudhën e ardhshme.

Fitimi ose humbja që paraqitet me rastin e shitjes ose nxjerrjes nga përdorimi i një pasurie përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të një pasurie dhe si rrjedhojë njihet si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave.

#### *(ii) Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi i pronës dhe paisjeve është llogaritur duke përdorur metodën drejtvizore për shpërndarjen e koston ose koston e konsideruar tek vlera e mbetur e tyre përgjatë jetëgjatësisë së tyre të përdorimit si në vijim:

Ndërtesat	20 vite
Pasuritë tjera jo qarkulluese	5 vite

**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

---

## **2.5 Të arkëtueshmet**

Të arkëtueshmet tregatë fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që Organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Shembuj të dëshmive objektive mund të jenë vështirësitë e mëdha financiare të klientit, probabiliteti i madh që klienti të falimentojë si dhe vonesat e vazhdueshme në pagesa.

## **2.6 Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shumë se tre muaj.

## **2.7 Të pagueshmet**

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë.

## **2.8 Tatimet**

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

## **2.9 Njohja e të hyrave**

Të hyrat njihen nga organizata me rastin e faturimit. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

## **2.10 Shpenzimet**

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza akruale.

## **2.11 Përfitimet e të punësuarve**

Organizata, bën pagesa në buxhetin e shtetit për llogari të puntorëve. Puntorët e Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e pensioneve të detyrueshme qeveritare shpenzohen kur ato ndodhin.

Për më tepër, Organizata nuk ka detyrime materiale për të siguruar përfitime të mëtejshme për puntorët paraprak dhe aktual.

**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

**3. PARAJA DHE EKVIVALENTET E PARASË**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)</b>
Gjendja e parasë në Teb Banka - Akont FIFA	1,953,175	-
Gjendja e parasë në Teb Banka	177,343	3,286,486
Gjendja e parasë në BKT	125,146	-
Gjendja e parasë në RBKO	742	24
<b>Total paraaja dhe ekuivalentet e parasë</b>	<b><u>2,256,406</u></b>	<b><u>3,286,510</u></b>

**4. LLOGARITË E ARKËTUESHME**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)</b>
Llogaritë e arkëtueshme	562,797	220,272
<b>Total llogaritë e arkëtueshme</b>	<b><u>562,797</u></b>	<b><u>220,272</u></b>

**5. AVANSET E DHËNA**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)</b>
Avanset e dhëna	50,121	260,015
<b>Total avanset e dhëna</b>	<b><u>50,121</u></b>	<b><u>260,015</u></b>

**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

**6. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET**

	Ndërtesa (në EUR)	Veturat (në EUR)	Pajisjet (në EUR)	Total (në EUR)
<b>Kostoja</b>				
Me 01 Janar 2020	179,996	105,835	392,442	678,273
Shtesa	-		12,901	12,901
<b>Me 31 Dhjetor 2020</b>	<b>179,996</b>	<b>105,835</b>	<b>405,344</b>	<b>691,175</b>
<b>Kostoja</b>				
Me 01 Janar 2021	179,996	105,835	405,344	691,175
Shtesa		227,707	840,301	1,068,008
<b>Me 31 Dhjetor 2021</b>	<b>179,996</b>	<b>333,542</b>	<b>1,245,644</b>	<b>1,759,182</b>
<b>Zhvlersimi</b>				
Me 01 Janar 2020	4,500	65,398	105,000	174,898
Ngarkesa per vitin	9,000	21,167	77,649	107,816
<b>Me 31 Dhjetor 2020</b>	<b>13,500</b>	<b>86,565</b>	<b>182,649</b>	<b>282,714</b>
<b>Zhvlersimi</b>				
Me 01 Janar 2021	13,500	86,565	182,649	282,714
Ngarkesa per vitin	9,000	52,131	231,768	292,898
<b>Me 31 Dhjetor 2021</b>	<b>22,500</b>	<b>138,696</b>	<b>414,417</b>	<b>575,612</b>
<b>Vlera neto</b>				
<b>Me 31 Dhjetor 2021</b>	<b>157,497</b>	<b>194,846</b>	<b>831,227</b>	<b>1,183,570</b>
<b>Me 31 Dhjetor 2020</b>	<b>166,496</b>	<b>19,270</b>	<b>222,695</b>	<b>408,461</b>

**7. LLOGARITË E PAGUESHME**

	Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Obligimi për tatimin në paga të punëtorëve	49,838	34,771
Llogaritë e pagueshme	76,206	57,855
Kontributet e punëtorëve	23,969	18,145
Kontributet e punëdhënësit	23,969	18,145
Tatimi I mbajtur në burim	-	635
Të pagueshmet tjera	54,779	-
<b>Total llogari të pagueshme</b>	<b>228,761</b>	<b>129,552</b>

**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

**8. TË HYRAT E SHTYERA**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)</b>
Detyrimet nga të hyrat e shtyra	<u>932,963</u>	<u>1,091,804</u>
<b>Total të hyrat e shtyra</b>	<b><u>932,963</u></b>	<b><u>1,091,804</u></b>

Diferenca mes të hyrave të shtyera për vitet 2021 dhe 2020 është në vlerë 158,841€ e cila është e paraqitur në shpalosjen 9 (rreshti 7) te pjesa e të hyrave.

**9. TË HYRAT**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)</b>
Të hyrat nga UEFA	8,903,682	4,740,247
Të hyrat nga FIFA	3,045,927	993,900
Të hyrat nga të drejtat autoriale	598,000	2,374,945
Të hyrat nga sponsorizimi	306,197	60,000
Të hyrat nga aktivitetet e zakonshme	195,909	180,484
Të hyrat nga subvencionet - MKRS	186,308	645,281
Të hyrat e shtyra	158,841	2,787,628
Të hyrat nga Federata Turke e Futbollit	165,000	-
Të hyrat nga marketingu	161,850	110,700
Të hyrat Viva Fresh - Liga e pare	100,000	-
Të hyrat nga organizimi i lojëve	60,453	45,470
Të hyrat - Projekti EU - Erasmus - Goals	19,106	-
Të hyrat nga participimi	12,500	1,750
Të hyrat tjera	<u>2,700</u>	<u>18,184</u>
<b>Totali i të hyrave</b>	<b><u>13,916,472</u></b>	<b><u>11,958,589</u></b>

**10. SHPENZIMET E PAGAVE**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)</b>
Shpenzimet e pagave	4,129,348	3,154,459
Shpenzimet e Kontributit të Punëtorëve	<u>176,067</u>	<u>138,159</u>
<b>Total shpenzimet e pagave</b>	<b><u>4,305,416</u></b>	<b><u>3,292,618</u></b>

**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

**11. SHPENZIMET E PROGRAMORE**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>
	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>
Ndihmat për klubet	1,501,937	1,131,357
Shpenzimet e udhëtimit	773,893	346,922
Shpenzimet - Drejtat TV Artmotion–Klubet S.Liga –Liga e parë	599,000	190,000
Shpenzimet për akomodim	507,391	367,946
Shpenzimet - Fondi Emergjent 2020	324,349	593,671
Shlyerja për klubet për vitet paraprake	271,400	183,578
Shpenzimet për organizimin e lojërave	263,330	234,204
Shpenzimet BKT - Super Liga	137,500	-
Shpenzimet për reprezentacion	126,330	69,137
Shpenzimet për transport	119,638	84,728
Shpenzimet për plasmanin e klubeve sipas rënditjes tabelare	100,500	-
Shpenzimet për pajisje sportive	96,969	28,594
Shpenzimet për marketing	95,043	75,210
Shpenzimet për mirëmbajtje	89,617	48,873
Shpenzimet e trajnimeve	80,436	24,850
Shpenzimet për material	52,431	38,803
Shpenzimet - Viva Fresh - Liga e parë	50,000	-
Shpenzimet për aplikim për viza	45,520	19,065
Shpenzimet për përfaqësim juridik	45,082	8,267
Shpenzimet e shpedicionit	31,139	140,893
Shpenzimet - Sistemi elektronik VAR	30,908	-
Shpenzimet e sigurimeve	29,121	31,953
Shpenzimet mjekësore	25,493	29,933
Shpenzimet - Liga e kadeteve	22,000	-
Shpenzimet për provizione	16,482	21,016
Shpenzimet për analist të statistikave	15,000	30,000
Shpenzimet - Ndihmë humanitare	12,822	-
Shpenzimet e shfrytëzimit të stadioneve	12,298	73,757
Sigurimet shëndetësore për ekipet nacionale	9,112	5,042
Shpenzimet e veshjeve sportive	6,030	-
Shpërblim për finalist Kupa 2020 - 2021 Femrat	6,000	-
Shpenzimet për printim	5,871	-
Shpenzimet e lojtarëve	3,059	584
Shpenzimet për anëtarësi	2,078	1,800
Shpenzimet -fituesi kupes Futsall	500	-
Shpenzimet MKRS ndihme klubeve - pandemia Covid 19	-	501,682
Shpenzimet - Ekipet perfituese Super Liga nga TV DigIt Alb	-	137,500
Shpenzimet - Klubet S.L perfituese IPKO	-	82,329
Shpërblimet për klubet nga FFK	-	53,000
Shpenzimet e gjobitjeve	-	10,030
Shpërblim për finalist Kupa 2019-2020 Femrat	-	6,000
Shpenzimet për tifoz	-	3,000
Shpenzimet tjera	-	2,000
<b>Shpenzimet programore</b>	<b>5,508,279</b>	<b>4,575,724</b>

**Federata e Futbollit të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

**12. SHPENZIMET E UEFA**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>
	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>
Shpenzimet - UEFA - Liga e kampionëve	1,995,000	1,899,945
Shpenzimet - solidariteti Liga nacionale - UEFA	374,112	763,615
Shpenzimet - UEFA - Europa Liga		51,236
Projekti - UEFA	70,000	47,104
<b>Total Shpenzimet e UEFA-së</b>	<b><u>2,439,112</u></b>	<b><u>2,761,900</u></b>

**13. SHPENZIMET E INVESTIMEVE DHE MIRËMBAJTJES**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>
	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>
Investim - Mirëmbajtja në fushat artificiale	489,329	-
Shpenzimet për investim - Stadiumi Hajvali	444,309	909,811
Investimet në ndërtesën e FFK-së	282,756	151,536
Investim - Mirëmbajtja për stadiumin Fadil Vokrri	35,278	35,337
Shpenzimet për renovimin e Stadiumeve - për klubet	-	-
Investim - Mirëmbajtja për stadiumin Adem Jashari	-	18,503
<b>Total shpenzimet e investimeve dhe mirëmbajtjes</b>	<b><u>1,251,672</u></b>	<b><u>1,115,186</u></b>

**14. SHPENZIMET E ADMINISTRATËS**

	<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>
	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>
Shpenzimet e rrymës	31,292	59,184
Shpenzimet e telefonit	29,863	17,278
Shpenzimet e internetit	25,943	17,042
Shpenzimet e zyrës	22,336	46,814
Shpenzimet e qirasë	20,637	15,570
Shpenzimet e ujit	5,261	362
Shpenzimet e taksave - Komunale	4,883	2,558
Shpenzimet e pastrimit	1,591	889
Shpenzimet e postës	633	383
Shpenzimet e parkingut	-	44
<b>Totali i shpenzimeve të administratës</b>	<b><u>142,440</u></b>	<b><u>160,124</u></b>



**15. NGJARJET E MËPASME**

Në kohën e përgatitjes së raportit të auditimit, organizata ka vazhduar operimet dhe ka qenë në gjendje t'i përmbushë obligimet, për këtë arsye raporti është përgatitë duke përdorur bazën e vijimësisë.

**From:** dojq@rks-gov.net  
**Sent:** Friday, March 18, 2022 10:04 AM  
**To:** ffk-kosova@hotmail.com  
**Subject:** Plotësim raporti

## **Njoftim për ndryshim statusi në raportin vjetor**

Ju njoftojmë se pas analizës të raportit vjetor për vitin '2021', për organizaten tuaj 'The Football Federation of Kosovo/ Federata e Futbollit e Kosovës', nuk është gjetur ndonjë parregullësi dhe nga kjo rezulton se raporti vjetor është i plotësuar, në përputhje me nenin 38-të Ligjit Nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare dhe nenit 11-të Udhëzimit Administrativ QRK - NR. 02/2014 Për Regjistrimin dhe Funkcionimin e Organizatave Joqeveritare. Për t'u kompletuar raporti vjetor, ju duhet të printoni raportin vjetor nga sistemi elektronik ta nënshkruani dhe të bashkëlidhni në sistem elektronik. Obaveštavamo vas da nakon analize godišnjeg izveštaja za godinu '2021', za vašu organizaciju 'The Football Federation of Kosovo/ Federata e Futbollit e Kosovës', nisu pronađene nepravilnosti i stoga se uspostavlja da je završen godišnji izveštaj, u skladu sa članom 38 Zakona B. 06 / L-43 o Slobodi Udruživanja u Nevladine Organizacije i članu 11 Administrativnog Uputstva VRK - BR. 02/2014 o Registraciji i Funkcionisanju Nevladinih Organizacija. Da biste kompletirali godišnji izveštaj, vi morate odštampati godišnji izveštaj iz elektronskog sistema, da ga potpišete i da ga priložite u elektronskom sistemu.

**From:** dojq@rks-gov.net  
**Sent:** Friday, March 18, 2022 12:51 PM  
**To:** ffk-kosova@hotmail.com  
**Subject:** Plotësim raporti

## **Njoftim për ndryshim statusi në raportin vjetor**

Ju njoftojmë se pas analizës së raportit vjetore, për vitin '2021' për organizatën tuaj '**The Football Federation of Kosovo/ Federata e Futbollit e Kosovës**', nuk është gjetur ndonjë parregullësi dhe si rezultat raporti i juaj vjetor konsiderohet i plotësuar në mënyrë të rregullt dhe merr statusin me përshkrimin '**I kompletuar**'.

### **Komenti rreth kompletimit të raportit vjetor**

*I nderuar, Raporti vjetor 2021 është i kompletuar*



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA / MINISTRY OF  
INTERNAL AFFAIRS

Departamenti për Regjistrimin e Organizatave Joqeveritare/ Departament za Registraciju Nevladine  
Organizacije/ Department for Registration of Nongovernmental Organisation

Certifikatë për Status të Përfitimit Publik  
Uverenje za Status Javnog Dobrobiti  
Public Benefit Status Certificate

Kjo Organizatë Joqeveritare është regjistruar në bazë të nenit 22 Ligjit Nr. 06/L-043. Për Lirinë  
e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.  
Navedena Nevladina Organizacija je Registrovana na osnovu clana 22 Zakona Br. 06/L-043, O  
Slobodi Udruživanja u Nevladinim Organizacijama u Republici Kosovu.  
The following Non Governmental Organisation is Registered under Law No. 06/L-043, section  
22 On Freedom of Association in Non-Governmental Organisations.

Nr. i Regjistrimit:  
Br. Registracia:  
Registration No:

5100477-9

Data e regjistrimit:  
Datum Registracije:  
Date Registered:

20/11/2000

Numri Fiskal:  
Fiskalni Broj:  
Fiscal Number:

600062327

Emri i plotë:  
Puno Ime:  
Full Name:

The Football Federation of Kosovo/ Federata e Futbollit e Kosovës

Shkurtesa:  
Skracenica:  
Acronym:

FFK

Nr. i SPP:  
Broj SJD:  
PBS No:

6001032-3

Data e dhënies SPP:  
Datum Izdavanja SJD:  
Date PBS Granted:

28/05/2009

Lëshuar më/ Izdato /Issued on:  
18/03/2022

Valide deri më/ do /Until:  
31/03/2023



Bajram Kosumi

Drejtor / Direktor / Director

Nr. Serik  
Br. Serije  
Serial No 012148

Mbeshtetur në Statutin e FFK, Komiteti Ekzekutiv me 10.12.2021 mori vendim për formimin e Komisionit Financiar për ri shikimin e pasqyrave financiare të FF të Kosovës, për periudhën kohore 01.01.2021 deri me 31. 12. 2021. Komisioni i lartëcekur mbajti mbledhjen e vet me datë 18.03.2022. Komisioni pati në disponim raportet financiare te parapara, të cilat u analizuan dhe shqyrtuan si bazë për të nxjerrë përfundimin e vet. Raportet financiare dhe sqarimet lidhur me to u analizuan dhe u vlerësuan së është i mjaftueshëm dhe valid për të krijuar bindjen për vlerësim nga ana e këtij Komisioni. Komisioni pas trajtimit të dokumentacionit financiar ra dakord që të paraqes këtë:

## RAPORT

1. Dokumentacioni i përgatitur financiar dhe i prezentuar, të cilin e kemi trajtuar, na bind se paraqet bazë reale dhe deshmi të mjaftueshme si në rexhistrimet , ashtu edhe në prezentimet ne pasqyrat financiare të periudhes raportuese;
2. Pasqyrat financiare të bashkëngjitura paraqesin pamje të drejtë, të të gjitha zërave , si dhe japin pamjen e vërtet e të drejtë të pozicionit financiar të FFK me datën 31 Dhjetor 2021, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që mbyllet më këtë datë. Bilanci i gjendjes dhe pasqyrat e të hyrave dhe të shpenzimeve paraqesin një pamje të saktë dhe reale në të gjitha aspektet;
3. Veprimet kontabel dhe operacionet financiare, sa kemi arritur të vlerësojmë, janë kryer në harmoni me vendime te brendshme, rregullat financiare të Federates, dhe rregulla të cilat janë të aplikueshme në Kosovë si dhe parime qe janë në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit financiar.
4. Transakcionet janë rexhistruar duke respektuar dhe zbatuar procedurat ligjore dhe ato administrative, si dhe vendimet që ka miratuar FFK-ja. Vlerësojmë se operacionet janë realizuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi;
5. Si Federate e Futbollit të Kosoves, si e vetme që ne baze te ligjit per Sport organizon ndeshjet nderkombetare, besojme qe aktivitetet e saja per sigurim te te ardhurave plotesuese nga ky aktivitet te trajtohen si jofitimprurese pasi nuk shtremberojne konkurencen. Menaxhmenti I FFK inkrajohet qe te siguroj nje sqarim te drejte nga autoritetet kompetente lidhur me kete.
6. Dokumentacioni financiar është sistemuar dhe ruajtur në mënyrë shumë korrekte. Konsiderojmë se Raportet financiare dhe dokumentacioni që kemi pasur në disponim është bazë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të krijuar dhe shprehur opinionin tone.
7. E vlerësojmë punën e personelit në zyrën e financave dhe kontabilitet dhe gatishmerinë gjatë rishikimit prezantimit, sqarimit dhe dokumentimit të raporteve financiare.

Prishtinë, 18.03.2022

Anëtarët e Komisionit:

1. Ymer Mehmeti,

2. Agim Bulliqi,

3. Fatmir Gashi,

